



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e54-të, të mbajtur më 01.11.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 09-1201 të 16.03.2021, Refuzohet.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk kishte mundësi të siguron informata shtesë për verifikimin e pretendimeve në denoncim.

Lënda me numër 09-1201 të datës 16.03.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më 16 mars 2021, një parashtrues i panjohur ka paraqitur një denoncim me pretendime të publikuara në portale se /// në nëntor të vitit të kaluar ka nënshkruar kontratë me kompaninë private /// për blerjen e materialit ndërtimor për nevojat e burgut në vlerë të përgjithshme prej ///denarë, pas së cilës është formuar lënda me numër 09-1201/1 nga 16.03.2021.

Në denoncim është bashkangjitur edhe marrëveshja me vlera sipas pozicioneve individuale, që prokurimi të kryhet nga të ardhurat e veta të institucionit, me procedurë të hapur për mbledhjen e ofertave dhe me publikim në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik. Ajo që është kontestuese në të gjithë rastin, siç ka thënë parashtruesi, është se pronari i kompanisë furnizuese ka qenë në marrëdhënie të ngushtë familjare me një punonjës ///.

Për të vërtetuar pretendimet dhe për të vërtetuar gjendjen faktike, redaksia e mediave ka kontaktuar drejtorin e ///, i cili ka deklaruar se procedurën e prokurimit publik e ka zhvilluar Komisioni i Prokurimit Publik dhe se ai nuk ka pasur asnjë ndikim gjatë saj, dhe konkretisht prokurimi është bërë me ankand elektronik përmes Byrosë së Prokurimit Publik, që do të thotë se asnjë filtër nuk është anashkaluar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, KSHPK konstaton se në kërkesë nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar se për cilin person bëhet fjalë, kur bëhet fjalë për konflikt të mundshëm interesi, për shkak të kontratës me një kompani në pronësi të një personi të afërt dhe jo mundësi për të dhënë informacion shtesë në lidhje me pretendimet në denoncim (denoncim anonim).

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën të këtij vendimi.

Përgatiti: EN, bashkëpunëtor
Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK - së

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska

